



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315

E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al

www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K4 / I49-2 Prot.
Nr. Dok. 202502873/2

Tiranë 17/12/2025

Lënda: Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve
në Shkodër

Drejtuar: Shërbimit Social Shtetëror

TIRANË

Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër

SHKODËR

Të nderuar,

Avokati i Popullit vlerëson bashkëpunimin e deritanishëm dhe angazhimin e punën e të gjithë stafit të institucionit që ju drejtoni. Në vijim po ju njohim mbi gjetjet dhe rekomandimet nga monitorimi që institucioni i Avokatit të Popullit kreu në institucionin tuaj më datë 10.06.2025.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim **Mekanizmi Kombëtar**, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, inspektoi Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, sipas Planit të Inspektimit të miratuar për vitin 2025 nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin znj. Gloria Çarkaxhiu, znj. Nertila Qafzezi dhe z. Vullnet Topalli me detyrë ndihmës komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar të institucionit të Avokatit të Popullit.

Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së këtij shërbimi, ndjekja e rekomandimeve të lëna nga vizitat e mëparshme nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe masat e marra për zbatimin e tyre, mbledhjen e informacionit lidhur me kushtet dhe trajtimin e të moshuarve, si dhe identifikimin e rasteve të mundshme të përdorimit ndaj kësaj kategorie të presionit psikologjik dhe përdorimin e forcës fizike tej kufijve, apo dhe mbajtjen në qendra rezidenciale pa vullnetin e tyre.

Vizita ishte e paparalajmëruar.

Avokati i Popullit, pasi shqyrtoi informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin ligjor, t'ju parashtrojë përfundimet e këtij monitorimi, si më poshtë vijon.

Objektivat e inspektimit:

- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga Avokati i Popullit në vitin 2024 si dhe gjendja aktuale;
- Respektimi i të drejtave të personave të moshuar, të cilët janë akomoduar në këtë institucion rezidencial, në zbatim të standardeve ligjore, të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Metodologjia

Grupi i inspektimit i Institucionit të Avokatit të Popullit si metodologji pune ka përdorur:

- ***Së pari***, zhvillimin e bisedave paraprake me Drejtorin e Qendrës dhe përgjegjësen e sektorit social, informacion, i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- ***Së dyti***, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale për të moshuarit.
- ***Së treti***, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të Shtëpisë të të Moshuarve Shkodër, ku ofrohen shërbime për personat e moshuar.
- ***Së katërti***, komunikimi me disa të moshuar, përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, të akomoduar në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër.

Rekomandimet e vitit 2024 dhe niveli i zbatimit të tyre

Nga inspektimi i mëparshëm i kryer në 28.06.2024, për problemet e konstatuara, Avokati i Popullit ka rekomanduar¹:

1. Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me dy infermierë dhe një psikolog, për të ofruar shërbim cilësor në shtëpinë e të moshuarve në Shkodër.
2. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror për shtim fondi buxhetor, në parashikimet e buxhetit për vitin 2025 për Shtëpinë e të Moshuarve

¹ Shkresa me nr. K4/I50-2 prot., datë 24.12.2024, “Rekomandim për inspektimin e kryer në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër”.

Shkodër, me qëllim mirëmbajtjen e institucionit dhe blerjen e pajisjeve përkatëse sipas nevojave.

3. Marrjen e masave për punësimin e një mjeku Psikiatër part time.
4. Marrjen e masave për ngritjen e një qendre socio-saniatre pranë shtëpisë së të moshuarve në Shkodër, ku të trajtohen me përkujdesje të veçantë të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.
5. Marrjen e masave nga Shërbimi Social Shtetëror, për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër.
6. Marrjen e masave menjëherë nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër, që kampionet ushqimore të ruhen të etiketuara sipas standardeve të përcaktuara.

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, Shërbimi Social Shtetëror ka informuar²:

- *Për rekomandimin nr. 1*, sqaron se Shërbimi Social Shtetëror ka nisur procesin e rishqyrtimit të strukturave të të gjithë institucioneve, përfshirë dhe Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër.
- *Për rekomandimin nr. 2*, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se SHSSH duke marrë parasysh kërkesat e institucioneve të paraqitura në projekt buxhet bën akordimin e fondeve në total për vitin pasardhës për institucionet e varësisë. Fondi i kërkuar dhe akorduar ka ardhur çdo vit në rritje. Gjithashtu gjatë Fazës II Programi Buxhetor Afatmesëm për vitin 2025-2027 Shtëpia e të Moshuarve Shkodër ka dërguar kërkesën për investime në pajisje elektrike të cilën SHSSH në bashkëpunim me MSHMS do ta realizojnë gjatë vitit 2025.
- *Për rekomandimin nr. 3*, Shërbimi Social Shtetëror sqaron se në bazë të ligjit nr. 10107, datë 30.03.2009, “*Për kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*” dhe në zbatim të sistemit të referimit, të gjithë shtetasit në Republikën e Shqipërisë kanë mjekun e tyre të familjes, i cili referon sipas nevojës dhe problemeve shëndetësore tek mjeku specialist sipas niveleve deri në nivel universitar për (konsulta dhe ekzaminime). Përfituesit e Institucioneve Rezidenciale Publik për të moshuar kanë të gjithë mjekun e tyre të familjes, i cili referon sipas nevojës dhe problemeve shëndetësore tek mjeku specialist, përfshi këtu dhe mjekun Psikiatër, procedurë e cila ndiqet edhe në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër.
- *Për rekomandimin nr. 4*, marrja e masave për ngritjen e një qendre socio-sanitare pranë shtëpisë së të moshuarve në Shkodër, ku të trajtohen me përkujdesje të veçantë të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore, Shërbimi Social Shtetëror sqaron: me shkresën nr. 2741 prot., datë 08.04.2024,

² Shkresë nr. 10012/1 datë 10.01.2025 “*Kthim përgjigje*”.

“Dërgim informacioni mbi Shtëpitë e të moshuarve” dhe nevojën e ngritjes së një shërbimi të ri për të moshuarit, jo autosuficientë. Ndërkohë, MSHMS në bashkëpunim me SHSSH dhe institucionet e përkujdesit, me Urdhrin e Ministrit nr. 251/2023 për rishikimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, me asistencën teknike të Programit të Mbështetjes Buxhetore “Përfshirja Sociale” EU4SI, ka hartuar dhe janë miratuar, standardet e rishikuara të shërbimit rezidencial për të moshuar, me Udhëzimin nr. 168, datë 29.03.2024 *“Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”*. Grupi i punës do të punojë për shkrimin e modelit të shërbimit, të standardeve të shërbimit të ri për të moshuarit, jo autosuficientë, ku do të parashikohen dhe standardet specifike strukturore që lidhen me infrastrukturën e godinës, pajisjet dhe strukturën që do të ofrojë shërbimin. Ky shërbim do duhet të parashikohet dhe në tipologjinë e shërbimeve, me rishikimin e kuadrit ligjor të shërbimeve të përkujdesit. MSHMS dhe SHSSH do të shikojnë mundësinë e përshtatjes së ndonjë godine ekzistuese, apo parashikimin e ndërtimit të një objekti për krijimin e një qendre për të moshuarit jo autosuficientë.

Për rekomandimin nr. 5, marrja e masave nga Shërbimi Social Shtetëror, për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër, sqarojmë se gjatë periudhës janar- dhjetor 2024 trajnimet e realizuara me stafin e Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër janë dy, si më poshtë:

1. Shërbimi Social Shtetëror ka realizuar bashkëpunimin me European Commission, Sue Ryder Care Albania dhe Bashkinë e Tiranës për trajnimin e Përgjegjësve Socialë dhe Psikologëve të institucioneve rezidenciale dhe ditore për të moshuarit, trajnim 3 (tre) ditor (20, 21 dhe 22 maj 2024), me temë *“Fuqizimi i kujdesit për të moshuarit: Një qasje gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve të mirëkoordinuara për të moshuarit”*. Nga Shtëpia e të Moshuarve Shkodër mori pjesë Përgjegjësja e Sektorit Social.
2. Shtëpia e të Moshuarve Shkodër në bashkëpunim me organizatën *“Help for life”* ka organizuar trajnimin e stafit gjatë muajit dhjetor, mbi temën *“Kujdesi mjekësor për të moshuarit”*, trajnim i akredituar.

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna në inspektimin e mëparshëm rezultoi se:

- Është zbatuar pjesërisht rekomandimi për marrjen e masave për shtimin në organikë me dy infermierë dhe një psikolog, pasi deri në rishikimin e organikës së institucionit janë punësuar me kohë të pjesshme dy infermierë dhe një psikolog.
- Është zbatuar pjesërisht rekomandimi për kryerjen e trajnimeve për stafin e Shtëpisë së të Moshuarve, Shkodër.

- Është zbatuar rekomandimi nga Drejtori i Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër, që kampionet ushqimore të ruhen të etiketuara sipas standardeve të përcaktuara.
- **Nuk** është zbatuar rekomandimi për punësimin e një mjeku Psikiatër part time.
- **Nuk** është zbatuar rekomandimi për ngritjen e një qendre socio-saniatre pranë shtëpisë së të moshuarve në Shkodër, ku të trajtohen me përkujdesje të veçantë të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.

Avokati i Popullit konstaton se përgjigjet e Shërbimit Social Shtetëror tregojnë bashkëpunim në lidhje me përmirësimin e kushteve sipas rekomandimeve të propozuara. Avokati i Popullit gjen rastin të theksojë se detyrimi për të garantuar të drejtat e njeriut dhe standardet e shërbimit është e parashkruar në ligj.

Komiteti për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës (KPT) gjatë vizitës së tij në Shqipëri në 4-15 Maj 2023, vizitoi disa nga shtëpitë e kujdesit shoqëror, (kategori në të cilat bëjnë pjesë edhe shtëpitë e të moshuarve) në Shqipëri dhe në raportin datë 24 nëntor 2023³, me rekomandime drejtuar Qeverisë Shqiptare, ka shprehur edhe një herë rezerva në lidhje me mbështetjen e pamjaftueshme financiare nga autoritetet qeveritare duke theksuar se: *“shtëpitë e kujdesit shoqëror, qofshin të financuara nga shteti, rajoni, bashkia ose tjetër, duhet të vendosen në një pozicion financiar për t’u ofruar banorëve **kujdes thelbësor dhe strehimin e duhur pa pasur nevojë të kërkojnë burime të jashtme si donatorët privatë ose publikë**”.*

Gjetjet e evidentuara përgjatë inspektimit:

Shtëpia e të Moshuarve në Shkodër, është një institucion publik rezidencial dhe ofron shërbime të përkujdesjes për të moshuar në nevojë, të cilët kanë mbushur moshën për pension pleqërie, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky institucion është në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror. Mbështetja financiare është e garantuar nga fondet e buxhetit të shtetit, nga programet e mbrojtjes sociale të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Shërbimit Social Shtetëror.

Shtëpia e të Moshuarve në Shkodër, ofron shërbime sipas standardeve të miratuara për personat e moshuar, të cilët janë të vetmuar apo të braktisur, sipas procedurave dhe verifikimeve të kryera për vlerësimin dhe referimin e rastit dhe që kanë nevojë për kujdes të vazhdueshëm.

Organizimi dhe funksionimi i këtij institucioni si dhe të drejtat dhe detyrimet e përfituesve, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të tij, e cila është e afishuar në ambientet e institucionit.

³ CPT Report 2023, <https://rm.coe.int/1680ae233b>

Monitorimi i zbatimit të standardeve të ofruara të shërbimeve sociale, kryhet nga Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e SHSSH-së, Shkodër, nga inspektimet e kryera të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Institutit të Higjienës, Agjencisë Kombëtare të Ushqimit etj.

Numri i përfituesve nga shërbimet e ofruara

Nga konstatimi paraprak u evidentua se në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër strehohen dhe ofrohen shërbime për persona të moshuar, mbi moshën 60 vjeç për gra dhe 65 vjeç për meshkuj, por shërbimi ofrohet edhe për 1 person nën moshën 60 vjeç.

Kapaciteti i institucionit për ofrimin e shërbimeve është për 65 persona të moshuar.

Gjatë inspektimit u evidentua se në këtë institucion trajtohen 65 të moshuar, nga të cilët 35 gra dhe 30 burra. Pjesa më e madhe e të moshuarve janë me probleme shëndetësore, nga të cilët 23 të moshuar nuk janë në gjendje të kryejnë vetëshërbime dhe kërkojnë kujdes të veçantë.

Nga dokumentacioni rezulton se në qendër përfitojnë trajtim 28 të moshuar nga moshë 60-70 vjeç, 34 të moshuar mbi 75 vjeç dhe 1 person nën moshën 60 vjeç. 28 të moshuar janë me familje, ndërsa 37 të moshuar janë pa familje.

Përfitues të pensionit të pleqërisë janë 53 të moshuar, ndërsa 12 të moshuar janë pa pension⁴.

Nga informacioni i marrë për periudhën janar- qershor 2025 rezulton se:

- Nuk ka të moshuar të larguar nga qendra.
- Kanë ndërruar jetë nga shkaqe natyrore 3 të moshuar;

Pjesa më e madhe e të moshuarve janë me probleme shëndetësore, 35 të moshuar vuajnë nga sëmundje të ndryshme kronike, 21 të moshuar me probleme të shëndetit mendor dhe 23 të moshuar me probleme të rënda shëndetësore, të cilët nuk janë në gjendje të kryejnë vetë shërbimet.

Mjekja në institucion ishte me kohë të pjesshme, e cila kryente vizita ditore dhe emergjente në shtëpinë e të moshuarve Shkodër. Vizitat dhe ekzaminimet nga mjekët specialist kryheshin në Poliklinikën e Specialiteteve në Shkodër dhe në Spitalin Rajonal Shkodër. Për çdo përfitues të shërbimeve të këtij institucioni ishte hartuar një plan i kujdesit shëndetësor, sipas nevojave të tyre specifike. Mjekja e qendrës jepte rekomandim për të mjeku specialist dhe të moshuarit dërgoheshin në datat respektive

⁴ Trajtohen sipas VKM nr.518, datë 04.09.2018, pika 68, a), për “Shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

të shoqëruar nga kujdestaret ku marrin dhe mjekimin ose jo në varësi të rezultatit të kontrolleve. Të gjitha ekzaminimet ishin të pasqyruara në kartelat individuale për gjithsecilin, të cilat administrohen nga mjekja e institucionit.

Shërbimi dentar realizohet në Poliklinikën e Specialiteteve Shkodër. Sipas nevojave të moshuarit shoqërohen nga kujdestaret për të marrë shërbimin dentar.

Sigurimi i medikamenteve me të cilat trajtoheshin të moshuarit vazhdon pa probleme, të gjitha medikamentet e nevojshme ishin të rimbursueshme, ndërsa pjesa tjetër e medikamenteve që nuk ishin të rimbursueshme, mbuloheshin me fondet e vetë institucionit. Në ambientet e infermierisë u kontrolluan dhe sasia e ilaçeve që ishte në dispozicion, të cilat ishin brenda afatit të skadencës.

Burimet njerëzore

Struktura e përcaktuar e personelit të këtij institucioni rezidencial përbëhet nga 28 punonjës⁵ nga të cilët janë me kohë të plotë 22 punonjës dhe me kohë të pjesshme 6 punonjës.

Gjatë turnit të parë punojnë 4 (katër) kujdestare dhe 2 (dy) sanitare dhe 1 (një) roje.

Gjatë turnit të dytë punojnë 1 (një) kujdestare dhe 1 (një) sanitare dhe 1 (një) roje.

Gjatë turnit të tretë punon vetëm 1 (një) kujdestare dhe 1 (një) sanitare.

Me trajtimin e problemeve psiko-sociale, të përfituesve të shërbimeve të ofruara është e ngarkuar 1(një) punonjëse sociale.

Shërbimet shoqërore ofrohen nga 10 (dhjetë) kujdestarë dhe 6 (gjashtë) sanitare.

Personeli shëndetësor në Shtëpinë e të Moshuarve në Shkodër përbëhet nga: 1 mjek me kohë të pjesshme (6 orë) dhe një infermiere, që punon 6 orë vetëm turnin e parë. Avokati i Popullit thekson se duke nisur nga nevoja e shtuar për përkujdes shëndetësor për të moshuarit 1 infermier është i pamjaftueshëm për të ofruar shërbimin për 54 të moshuar. Nevojitet në vijim rishikimi i strukturës organike me qëllim ofrimin e një shërbimi shëndetësor sa më cilësor dhe në kohë. Vlerësimi i punës së stafit bëhet çdo vit nga drejtuesi i institucionit.

Nga numri i përgjithshëm i banorëve (65) 23 moshuar nuk kryejnë vetëshërbim të cilët kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme për nevoja personale. Kujdesi për këta persona ka nevojë për mbikëqyrje të vazhdueshme dhe stafi duhet të kujdeset për higjienën e tyre personale, ushqimin e rregullt dhe nevojat e tjera të rastit.

Gjatë inspektimit nga verifikimi i kartelave mjekësore vërehet rritja e numrit të të moshuarve me probleme të shëndetit mendor, 21 të moshuar për vitin 2025. Për të adresuar nevojat e tyre fizike, sociale dhe emocionale, në mënyrë që të parandalohet përkeqësimi i funksioneve njohëse, depresionit, ankthit, demencës dhe çrregullimeve

⁵ Struktura e miratuar nga Shërbimi Social Shtetëror, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 88, datë 25.11.2011.

të tjera psikiatrike, që shfaqen me rritjen e moshës, këta të moshuar kanë nevojë për ekzaminime mjekësore periodike dhe terapi rehabilituese.

Një ekip multidisciplinar që përfshin mjekë psikiatër, psikolog, infermier dhe punonjës social është thelbësor për të garantuar që çdo aspekt i kujdesit për të moshuarit me probleme të shëndetit mendor të trajtohet në mënyrë efektive.

Propozimi për shtimin e një psikiatri me kohë të pjesshme dhe një psikologu me kohë të plotë, do të ndihmojë në përmirësimin e shërbimeve, reduktimin e kohës së pritjes dhe personalizimin e trajtimit për çdo të moshuar. Po ashtu, një pjesë e të moshuarve janë në gjendje të vështirë e nuk mund të transportohen lehtë në poliklinikë.

Për realizimin e shërbimeve apo detyrave, kujdestari për të moshuar duhet të zotërojë njohuri që kanë të bëjnë me: ndihmën e parë për individët e moshuar, me kujdesjen trupore personale, me zbatimin e procedurave të ushqyerjes, të zhveshjes-veshjes, të larjes, të dhënies së medikamenteve, etj. Shërbimet shoqërore ofrohen nga kujdestarë të cilët nuk kanë mbaruar të gjithë një shkollë të mirëfilltë për profesionin e infermierit. për të zbatuar në mënyrë sa më konkrete dhe korrekte programe të përkujdesjes psiko-sociale.

Gjithashtu, trajnimi i kujdestarëve do të rriste kapacitet e tyre në shërbim të të moshuarve duke rritur cilësinë e jetesës së përfituesve të kësaj qendre rezidenciale.

Avokati i Popullit thekson se, duke pasur parasysh natyrën sfiduese të punës së tyre dhe nevojat e banorëve, është me rëndësi thelbësore që stafi kujdestar të marrë në vazhdimësi trajnimin e duhur për punën e tyre.

Një nga vështirësitë e punës për personelin janë mungesa e hapësirave dhe aksesit për të kryer shërbimin sipas standardeve, përfshirë dhe mungesën e një mjedisi terapeutik me pajisje speciale për të moshuarit që janë me probleme shëndetësore. Ky ambient duhet të përfshijë hapësira të dedikuara për terapi grupi, aktivitete krijuese dhe relaksim, duke ndihmuar në reduktimin e stresit dhe promovimin e mirëqenies psikologjike.

Ambientet e Shtëpisë së të Moshuarve në Shkodër

Shtëpia e të Moshuarve në Shkodër ndodhet në dy godina, godina A dhe godina B, të cilat janë godina dy katëshe. Në katin e parë të godinës B gjenden dhomat, ku ishin sistemuar të moshuar me probleme shëndetësore.

Të moshuarit të cilët kishin probleme shëndetësore kishin akses në përdorimin e rampave në institucion.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar standarde⁶ specifike për kujdesin ndaj të moshuarve, të cilat synojnë përmirësimin e shërbimeve dhe respektimin e dinjitetit të tyre. Konkretisht standardi nr. 8 “Mjedisi fizik dhe pajisjet”, fokusohet në krijimin e një mjedisi fizik të sigurt, të rehatshëm dhe të përshtatshëm për të moshuarit.

Shtëpia e të Moshuarve në Shkodër ka ambiente shumë komode, të pastra, të ajrosura dhe me ndriçim të bollshëm. Dhomat ishin të pastra, kishte dritë të mjaftueshme natyrore. Evidentuar se dhomat e të moshuarve kishin kushte të mira, të arregduara dhe komode për ta, shtretër dhe dollapë që tregonin që ambienti ishte i personalizuar për çdo banor. Të moshuarit ishin të akomoduar nëpër dhoma nga 1 apo 2 persona.

Institucioni planifikon çdo vit buxhet për pajisje dhe kishte bërë blerje për: pajisje higjienike, detergjente e material pastrimi, veshje për të moshuar, enë kuzhine dhe material hotelerie, si batanije e çarçafë.

Konsumimi i shtretërve dhe dyshekëve apo dhe dëmtimi i tyre, si dhe kërkesa e evidentuar edhe gjatë inspektimeve të mëparshme, për shtretër dhe dyshekë për të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore, kërkon planifikim zëra shtesë të buxhetit për blerjen e këtyre pajisjeve. Megjithatë vlerësojmë se Shtëpia e të Moshuarve Shkodër ishte pajisur me 10 shtretër me mekanizëm të dedikuar për personat të cilët nuk kryejnë dot vetëshërbim.

Në mënyrë që të realizohen standardet e miratuara, Shërbimi Social Shtetëror, duhet të miratojë fonde shtesë vit pas viti për investime apo dhe riparime thelbësore, blerje mobiliesh, madje edhe sendet që lidhen me kujdesin personal, të përshtatshme për banorët dhe produktet personale, janë thelbësore për ofrimin e shërbimeve me standarde për këta banorë.

Avokati i Popullit konsideron se alokimi i fondeve të mjaftueshme për Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, do të sigurojë që standardet të mos mbeten thjesht teorike, por të përkthehen në kushte reale që rrisin cilësinë e jetës së të moshuarve duke ju ofruar banorëve kujdes thelbësor dhe strehimin e duhur (shtretër, dyshekë dhe pajisje të kujdesit personal etj.).

Në një ambient të veçantë ishin të afishuara rregulloret e jetës së brendshme, standardet që duhet të respektojnë punonjësit e këtij institucioni, si dhe ishte vendosur edhe “kutia e ankesave”, ku depozitoheshin ankesat e të moshuarve. “Kutia e ankesave” hapej një herë në muaj, në prani të një përfaqësuesi të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Shkodër, të Punonjësit Social, si edhe një i moshuar, përfitues i kësaj qendre.

⁶ Udhëzimi Nr.168, datë 29.03.2024, “Për miratimin e standardeve të shërbimit të përkujdesit shoqëror për të moshuar në qendrat rezidenciale dhe manuali i zbatimit”.

Mjetet për shmangien e rreziqeve që mund të vijnë nga rastet e emergjencave civile, ishin të vendosura në vende të veçanta në korridore sipas standardeve. Kolaudimi i tyre bëhet 1 herë në vit. Stafi ishte trajnuar për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit. Godina është e pajisur me impiant për rastet e rënies së zjarrit, me shkallë dhe dyer emergjence si dhe tregues për këto dalje. Ka një plan të miratuar për veprimet e personelit dhe të moshuarve në këto raste.

Ngrohja dhe ftohja realizohej me sistemin chiller dhe ishte funksionale.

Ambienti i kuzhinës ishte i pastër, i pajisur me soba profesionale, frigorifer etj. Kampionët e ushqimeve për të treja vaktet ruheshin në frigorifer, dhe ishin të etiketuara me datën përkatëse.

Kuota ushqimore është rritur tashmë në 430 lekë në ditë⁷, prej 360 lekësh në ditë, për shkak të rritjes së çmimeve dhe kostos së jetesës, nisur dhe nga Rekomandimet e bëra ndër vite nga Avokati i Popullit. Rritja e kuotës ushqimore me 19.44%, është mbi nivelin e kostos minimale të shportës ushqimore në Shqipëri, sipas normës ditore të kalorive për një të rritur⁸.

Për përcaktimin e menusë dhe oraret e vakteve të ngrënies, merrej mendimi i të moshuarve. Menuja javore firmoset nga një i moshuar, që mund edhe të ndryshohej po nga të moshuarit sipas preferencave. Për 5 persona që janë diabetikë ishte miratuar menu e veçantë e përshtatur për nevojat e tyre.

Në datë 22.05.2025 ishte realizuar dezinfektimi i plotë i hapësirave të brendshme dhe të jashtme.

Ambientet ishin të monitoruara me sistem kamerash i cili ishte funksional i përbërë nga 15 kamera. Filmimet e tyre ruhen 1 muaj dhe menaxhohen nga drejtuesi i qendrës.

Jeta social-kulturore

Përsa i përket jetës sociale, nga informacioni i marrë gjatë inspektimit, u konstatua se organizoheshin aktivitete të ndryshme: ditëlindje, festa fetare, festat zyrtare, etj. Gjithashtu disa të moshuar ndjekin ritet fetare.

⁷ Udhëzimi nr. 662, datë 06.12.2022, “Për një ndryshim në udhëzimin nr. 689, datë 02.10.2018, për nivelin e kuatove të shpenzimeve për ushqime, në Institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”.

⁸ Raporti i institucionit të Avokatit të Popullit “Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri”, Tabela 10. Kostoja minimale e shportës ushqimore në Shqipëri sipas normës ditore të kalorive për 1 të rritur (vlera mujore 7427 lekë). Burimi INSTAT.

Qendra ofronte ambiente argëtimi për të moshuarit, si sallë bilardo, biblioteka, salla e veglave për ushtrimin fizik dhe salla e ndenjes që shërben për relaksimin e të moshuarve. Ka oborr dhe lulishte me hapësira të mjaftueshme për aktivitete për kohën e lirë të përfituesve.

Çdo kat i institucionit ka dhoma me TV ku kalojnë kohën e lirë të moshuarit. ka gjithashtu një hapësirë për të luajtur shah, domino dhe letra ku banorët mund të luajnë dhe të kalojnë kohën e lirë.

Gjithashtu, ishin organizuar aktivitete e takime të ndryshme si:

- ✓ Takimi me të rinjtë e shtëpisë së të rinjve marrin pjesë në ndeshjen Vllaznia-Apollonia;
- ✓ okupacionale me të moshuarit që kanë probleme me demencën;
- ✓ ludotike lojë domino, me letra;
- ✓ qepje qëndisje kujdesi për veten, punë me lapsa;
- ✓ takohemi një kafe së bashku;
- ✓ marrim pjesë në shfaqje ..., etj.

Avokati i Popullit inkurajon zhvillimin e aktiviteteve dhe eventeve sociale, për të promovuar relaksimin dhe për të luftuar izolimin për këta banorë.

Takimet dhe vizitat me të afërmit kryheshin sipas dëshirës së tyre dhe mundësive të të afërmeve. Realizohet edhe komunikimi telefonik, të cilat mbahen në një regjistër të veçantë.

Në ditën e inspektimit të moshuarit u takuan nga ana jonë nëpër dhoma, në oborr dhe në ambientet e jashtme të godinës dhe u zhvilluan biseda me ta, pa praninë e stafit, nga të cilët nuk patëm ankesa.

Problematikat e konstatuara:

- Mungesa e Mjekut me kohë të plotë në institucion
- Mungesa e një mjeku Psikiatër dhe psikologu kufizon mbështetjen për trajtimin e të moshuarve me probleme të shëndetit mendor.
- Mungesa në numrin e stafit të infermierëve kjo referuar numrit të të moshuarve në këtë institucion.
- Mungesa e një ambient terapeutik, për të moshuarit që nuk kryejnë dot vetëshërbim i cili do mund të përdoret jo vetëm për këtë kategori e të sëmurëve, por edhe për të moshuarit e tjerë. Sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, për aktivitetin fizik të të moshuarve

mbi moshën 65 vjeç, “çdo aktivitet fizik vlen sado i vogël që të jetë”, do të ishte i nevojshëm punësimi i një fizioterapisti në këtë qendër.

Sa më sipër, për të plotësuar standardet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit në institucionet rezidenciale, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa ku vërehen shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar ku thuhet se *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive,*

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave përkatëse për shtim në organikë të pozicionit të punës me një mjek me kohë të plotë dhe një psikolog, për të ofruar shërbim cilësor në shtëpinë e të moshuarve në Shkodër.
2. Marrjen e masave për punësimin e një mjeku psikiatër me kohë të pjesshme.
3. Marrjen e masave për shtimin në organikën e Shtëpisë së të Moshuarve Shkodër me 2 infermierë kjo në përputhje me numrin e të moshuarve të cilët marrin shërbim shëndetësor.
4. Marrjen e masave për ngritjen e një qendre socio-sanitare pranë shtëpisë së të moshuarve në Shkodër, ku të trajtohen me përkujdesje të veçantë të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar lutemi të vihem në dijeni brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtyre rekomandimeve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

**KOMISIONERI
i Mekanizmit Kombëtar
për Parandalimin e Torturës
(MKPT)**

**Ahmet PRENÇI
d.v**